

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
WEB DIZAJN

Kodi: PK-T-2-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“WEB DIZAJN”

(Kodi: PK-T-2-22)

I. Profili profesional i operatorëve për web dizajn:

a) Karakteristikat e operatorëve për web dizajn

Operatori (zhvilluesi) për web dizajn merret me mirëmbajtjen, monitorimin dhe jep mbështetje për funksionimin optimal të faqeve të Internetit dhe Intranetit, të harduerëve dhe softuerëve të web server-ëve. Modifikon *web* faqet, kryen operacionet e *back-up* dhe të rimëkëmbjes së *web server*, siguron ndihmë teknike për përdoruesit, në mënyrë direkte ose me anë të telefonit, *e-mail* apo mjeteve të tjera elektronike.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale

Profesioni operatorit për web dizajn është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në lidhje me përdorimin e gjuhës së kodeve për krijimin e përmbajtjes e faqeve të internetit, për stilimin e përmbajtjes së faqeve të internetit, dhe interaktivitetin e tyre. Dizenjuesi i *Web-it* realizon përpunimin dhe optimizimin për faqet e thjeshta të internetit, të figurave në programin photoshop, për krijimin, zhvillimin edhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit. Ai mund të punësohet në kompani të ndryshme që ofrojnë shërbime të TIK, në shoqëri tregtare që kanë departamente të shërbimit për përdorues të TIK si dhe të vetëpunësohen.

Përfundimi me sukses i këtij kursi i jep mundësi kursantit të kalojë ose të zhvillohet në profesione të tjera që kanë të bëjnë me web dizajn si; teknik administrimi website, webmaster etj. Këto kërkojnë përvojë pune, kualifikime të mëtjshme dhe shkollimet përkatëse.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në grupin e profesioneve “Teknikë website”, me kod 3514, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Web dizajn”.

Në përfundim të Kursit për “Web dizajn”, kursantët do të jenë të aftë të:

- konsultohen me klientët, për kërkesat e faqes që do të disenjohet apo modifikohet.
- konsultohen me kolegët për porositë e marra nga klientët, si dhe për mbarëvajtjen e punës.
- formulojnë strukturën e faqes “web” sipas kërkesave të klientit;
- vendosin të dhënat në faqen “web” sipas kërkesave të klientit;
- krijojnë bazën e të dhënave;
- publikojnë faqen “web” në “web” space-in e klientit;
- krijojnë link-et e nevojshme në faqen “web”;
- bëjnë modifikime periodike ose jo periodike të faqes “web” sipas kërkesave të klientit;
- mirëmbajnë “website”;
- përditësojnë faqet e internetit;
- bëjnë “back-up”-in e “website”-it;
- bëjnë testimin e faqes;

- bëjnë kontrollin e nivelit të aksesit;
- bëjnë monitorimin dhe japin mbështetjen optimale për funksionimin e faqeve të internetit, të intranetit, të “harduerëve” dhe “softuerëve” të “web” server-it;
- bëjnë ruajtjen e dokumentacionit;
- bëjnë zhvillimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e masave të sigurisë;
- bëjnë rekomandime për të përmirësuar performancën;
- rekomandojnë (ose japin ide) për blerje të sistemeve të reja;
- krijojnë lidhje me sisteme të reja;
- japin udhëzime për këto sisteme, klientëve përdorues;
- modifikojnë faqe të “web”-it;
- testojnë faqen “web” dhe bazën e të dhënave;
- kryejnë “backup” dhe operacione të tjera të sigurisë të “web” server-it;
- konsultohen me udhëzuesit e përdorimit, manuale teknike dhe dokumenteve të tjera të kërkimit dhe gjejnë zgjidhje të problemeve të hasura;
- bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Web dizajn”

Pjesmarrësit në Kursin për “Web dizajn” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Web dizajn”

360 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Web dizajn”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it.	MK-26-312-22	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit të web-it. 2. Kursanti përshkruan ndërtimin dhe strukturën e faqeve të web-it. 3. Kursanti përshkruan strukturën e ndërtimit të dosjes që përmban sitin.

2	Strukturimi dhe stilimi i faqeve web	MK-26-313-22	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti zhvillon kode dhe tekste me kodet HTML 2. Kursanti zhvillon lidhjet dhe paraqitjen e figurave me kodet HTML 3. Kursanti zhvillon tabela dhe forma me kodet HTML 4. Kursanti zhvillon elemente të multimedive dhe sektorëve divizion 5. Kursanti tregon konceptet dhe qëllimin e kodeve CSS dhe selektorët 6. Kursanti krijon kode CSS mbi HTML, stilime dhe efekte mbi tekstin 7. Kursanti kryen zhvillimin e hapësirave dhe zhvendosje të objekteve me CSS. 8. Kursanti përdor teknika dhe efekte të avancuara në CSS
3	Shtimi i animacioneve dhe përshtatja për pajisje të ndryshme.	MK-26-314-22	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti shton Javascript në faqet web. 2. Kursanti shton animacione të ndryshme në faqet web 3. Kursanti përshtat faqet web për pajisje të ndryshme.
4	Testimi, publikimi dhe mirëmbajtja e faqeve web.	MK-26-315-22	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti realizon testimin e faqes web para publikimit. 2. Kursanti realizon publikimin online të faqes web. 3. Kursanti realizon mirëmbajtjen e faqeve web.
5	Dizenjimi i faqeve web nëpërmjet CMS-ve	MK-26-316-22	30 orë Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti analizon dhe përzgjedh një nga CMS-te për ndërtimin e web-it 2. Kursanti instalon dhe përdor CMS për ndërtimin e web-it.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Web dizajn”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it.”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E DIZENJUESIT TË WEB-IT	MK-26-312-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të dizenjuesit të Web-it, me mënyrën e funksionimit të faqeve të internetit, strukturën e faqeve të internetit, mënyrat e ndërtimit të faqeve dhe konceptet baze për transferime të dosjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit të web-it. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës të dizenjuesit të web-it;– të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës të dizenjuesit të web-it;– të tregojë kërkesat profesionale dhe mundësitë e punësimit të dizenjuesit të web-it;– të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të profesionit të dizenjuesit të web-it;– të përshkruajë mënyrat e ndërtimit dhe funksionimit të internetit;– të përshkruajë konceptet server, client-side, front- end;– të zbatojë rregullat e komunikimit me eprorët, kolegët, klientët;– të zbatojë legjislacionin e punës;– të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Pyetje përgjigje me shkrim.	
	RN 2 Kursanti përshkruan ndërtimin dhe strukturën e faqeve të Web-it. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

-
- të përshkruajë llojet e ndërtimit të faqeve web;
 - të tregojë diferencën, përparësitë dhe mangësitë midis llojeve;
 - të përshkruajë rradhën e veprimtarive në ndërtimin e faqeve web;
 - të tregojë rëndësinë për çdo etapë;
 - të përshkruajë strukturën bazë të faqeve web;
 - të tregojë rolin e çdo elementi të strukturës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan strukturën e ndërtimit të dosjes që përmban sitin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë strukturën e ndërtimit të dosjeve;
- të emërtojë dosjet që përmban sitin;
- të përshkruajë rolin e dosjeve;
- të përshkruajë lidhjet e faqeve HTML me dosjet që përmban root dosja.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratore informatike, kompani shërbimesh kryesisht për zhvillime web-i dhe mjedise pune ku kryhen dizenjime dhe programime në web.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të interpretimit dhe realizimit të koncepteve kryesore të këtij profesioni.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Instruktori duhet të nxisë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike dhe aftesive të fituara që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në kabinet kompjuterik.
 - Kompjuterat me programe aplikative të instaluar.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Strukturimi dhe stilimi i faqeve web”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	STRUKTURIMI DHE STILIMI I FAQEVE WEB	MK-26-313-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët në krijimin e strukturës së faqeve web, në krijimin e përmbajtjes së faqeve, elementët dhe sektorët e krijuar brenda strukturës HTML, komunikimin me shfletuesin, njohjen me elementet e faqes, përdorimin e kodeve TAG. Moduli gjithashtu i njeh kursantët me gjuhën e kodeve CSS, stilimin e përmbajtjes së krijuar me HTML, teknikën e stilit, mënyrën e implementimit, pozicionimin e objekteve dhe sektorëve të faqes, strukturimin e faqeve me CSS.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të përdorin programet bazë kompjuterike dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti zhvillon kode dhe tekste me kodet HTML. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të tregojë qëllimin dhe rolin e kodeve HTML;– të zhvillojë deklaronet në fillim të çdo faqeje web;– të zhvillojë kllapat hapëse dhe mbyllëse;– të zhvillojë sintaksën e kodeve HTML;– të zhvillojë kodet në HTML të titujve, modifikimit të karaktereve të tekstit;– të zhvillojë kodet në HTML të paragrafëve, llojit të tekstit;– të zhvillojë kodet në HTML të madhësisë së tekstit, të ndryshojë ngjyrën;– të zhvillojë kodet në HTML të attributeve dhe vlerave; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli. <p>RN 2 Kursanti zhvillon lidhjet dhe paraqitjen e figurave me kodet HTML. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të zhvillojë kodet HTML;– të krijojë lidhje me kodet në HTML;– të përshkruajë llojet e lidhjeve që përdoren në HTML;– të zhvillojë llojet e lidhjeve që përdoren në HTML;– të zhvillojë navigime të brendshme në faqe;– të zhvillojë kodet në HTML të fotografive;– të zhvillojë kodet në HTML të dimensioneve, raportit të figurave;	

- të zhvillojë formatet e figurave digitale dhe ti zbatojë në kode.
- të përshkruajë profilet e ngjyrave;
- të përshkruajë sintaksën e paraqitjes së ngjyrave me kode;
- të tregojë llojet e listave dhe elementët përbërës të tyre;
- të zhvillojë modifikime në lista;
- të alternojë listat me tekste, foto, lidhje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Kursanti zhvillon tabela dhe forma me kodet HTML.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të zhvillojë tabela me kodet në HTML;
- të krijojë tabela me kodet në HTML;
- të zhvillojë modifikime në tabela;
- të zhvillojë struktura faqeje me tabela;
- të njohë elementet e formularëve ne HTML;
- të zhvillojë formularë me HTML;
- të zhvillojë fusha te llojeve te ndryshme brenda formularit;
- të krijojë fusha të llojeve të ndryshme brenda formularit;
- të zhvillojë atributet dhe vlerat e inputeve të formularit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti zhvillon elemente të multimedive dhe sektorëve divizion.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të zhvillojë audio dhe video me kode HTML;
- të zhvillojë dimensionet e medias me kode HTML;
- të zhvillojë media nga platforma multimediale online;
- të zhvillojë sektorë të posaçëm me kode HTML për faqe web;
- të zhvillojë strukturime faqesh me sektorët division në dokumentin HTML;
- të zhvillojë kodet në HTML për emërtimet e divizioneve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursanti tregon konceptet dhe qëllimin e kodeve CSS dhe selektorët.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë qëllimin dhe rolin e kodeve ctss;

- të tregojë mënyrat e implementimit të kodeve;
- të përshkruajë sintaksën e kodeve CSS;
- të krijojë selektorë CSS;
- të tregojë sintaksën e të shkruarit dhe të kërkuarit të selektorëve;
- të tregojë grupimet e selektorëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Kursanti krijon kode CSS mbi HTML, stilime dhe efekte mbi tekstin

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë 3 mënyrat e veprimeve të kodeve CSS;
- të krijojë veprime inline me CSS;
- të krijojë veprime internal me CSS;
- të krijojë veprime external me CSS;
- të tregojë rëndësinë për formatim teksti me CSS;
- të tregojë rëndësinë për centrim teksti me CSS;
- të tregojë rëndësinë për ngjyrat dhe efektet e tekstit me CSS.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Kursanti kryen zhvillimin e hapësirave dhe zhvendosje të objekteve me CSS.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë hapësirat e brendshme dhe të jashtme të një objekti;
- të zhvillojë hapësirat e brendshme dhe të jashtme të një objekti;
- të kryejë zhvendosje majtas-djathtas të objekteve;
- të kryejë alternime të figurave dhe tekstit në zhvendosje;
- të tregojë llojet e pozicionimeve të objekteve me CSS;
- të kryejë relacionet prindër - fëmijë midis objekteve;
- të zhvillojë struktura faqe me pozicionime.
- të zhvillojë attribute dhe vlera për sfondin e objektit;
- të zhvillojë attribute dhe vlera për fotografitë;
- të zhvillojë attribute dhe vlera për transparencën e sfondit;
- të njohë elementet bazë të strukturës së një faqe web;
- të zhvillojë sektorin e kreut të faqes;
- të zhvillojë sektorin e fundit të faqes;
- të zhvillojë sektorin e galerisë së fotove të faqes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 8 Kursanti përdor teknika dhe efekte të avancuara në CSS

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përdorë teknika dhe efektet për konturet e objekteve;
- të përdorë teknika dhe efekte për animacionin e objekteve;
- të përdorë teknika dhe efekte për hover;
- të zhvillojë menu navigimi të stiluar me CSS;
- të kryejë shfaqje të kontrolluara të teksteve dhe fotove;
- të përdorë teknika dhe efekte për transparencën, tranzitimin dhe transformimin e objekteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës në një studio.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj. Atyre duhet t’iu jepen detyra si psh të krijojnë tabela me kodet në *HTML* dhe të kryejnë modifikime në tabela, si dhe të kryejnë zhvendosje të objekteve në *CSS* apo të përdorin teknika dhe efekte për transformimin e objekteve. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në kabinet kompjuterik.
 - Kompjuterat me programe aplikative të instaluar.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materialet të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Shtimi i animacioneve dhe përshtatja për pajisje të ndryshme”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHTIMI I ANIMACIONEVE DHE PËRSHTATJA PËR PAJISJE TË NDRYSHME	MK-26-314-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të realizuar shtimin e animacioneve dhe përshtatjen e faqeve web për pajisje të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranimit	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të përdorin programet bazë kompjuterike dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizajnuesit të web-it”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti shton Javascript në faqet web. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të realizojë lidhjen e skedarëve html me skedarët <i>javascript</i>; – të dallojë gabimet sintaksore në kodin e një programi në gjuhën <i>JavaScript</i>; – të zgjedhë tipin e variablave për llojin e të dhënave që do të përdorin; – të shkruajë programe që përfshijnë veprime me variablat në <i>JavaScript</i>; – të shkruajë programe që përfshijnë operatorët aritmetikë, logjikë, të krahasimit sipas rastit; – të shkruajë programe që përfshijnë kushtëzimin <i>if.. else dhe else...if sipas rastit</i>; – të shkruajë programe që përfshijnë <i>switch</i>; – të shkruajë programe që përfshijnë ciklet <i>for, while, do..while</i>; – të shkruajë programe që manipulojnë vektorët dhe matricat në <i>JavaScript</i>; – të shkruajë programe duke përdorur funksionet, objektet dhe klasat; – të modifikojë objektet e <i>DOM</i> nëpërmjet kodit <i>JavaScript</i>; – të modifikojë pozicionin e objekteve të <i>DOM</i> në faqen web nëpërmjet kodit <i>JavaScript (layers, CSS, DHTML)</i>; – të modifikojë pamjen e objekteve të <i>DOM</i> (ngjyrën, madhësinë etj.); – të modifikojë përmbajtjen e elementeve të <i>DOM</i> nëpërmjet <i>JavaScript</i>; – të testojë vazhdimisht kodin e shkruar; – të shënojë komentet përkatëse përgjatë kodit të shkruar <p>Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.</p>	

RN 2 Kursanti shton animacione të ndryshme në faqet web.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të listojnë llojet më të përdorura të librarive javascript;
- të krahasojnë llojet e librarive javascript;
- të përzgjedhë libraritë javascript;
- të shkarkojë librarinë nga faqja zyrtare ose të realizojë lidhjet me anë të *CDN*;
- të instalojë librarinë në ambientin e zhvillimit të kodit;
- të realizojë animime të teksteve;
- të realizojë animime të butonave;
- të realizojë animime të menuve të faqeve web;
- të realizojë animime të imazheve (*efektet e slideve*);
- të realizojë validimin e kontakt formave të ndryshme;
- të shtojë funksionalitetet e librarisë sipas dokumentacionit përkatës të librarisë;
- të testojë vazhdimisht kodin e shkruar;
- të shënojë komentet përkatëse përgjatë kodit të shkruar;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përshtat faqet web për pajisje të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të interpretojë rëndësinë e responsivitetit në faqet web;
- të interpretojë rëndësinë e *fluid grids, fluid media, media queries të responsive-tetit* të faqeve web;
- interpretojë elementët e *grid layout-it* në faqet web;
- të shkruajë instruksionet CSS të reponsivitetit për faqet web;
- të interpretojë përdorimin e teknikës *flexbox*;
- të shkruajë kodin e viewport në faqet web;
- të shkruajë instruksionet e optimizimit të teksteve për faqet web;
- të shkruajë instruksionet e optimizimit të imazheve për faqet web;
- të përshtasë ikonat në formatin *SVG*;
- të listojnë llojet më të përdorura të *framework-ve* mbi responsivitetin e faqeve web;
- të krahasojnë llojet e *framework-ve* të responsivitetit;
- të përzgjedhë *framework-un* i cili përshtat faqet web për pajisje të ndryshme;
- të shkarkojë *framework-un* nga faqja zyrtare;
- të instalojë ose të realizojë lidhjet me anë të *CDN* në ambientin e zhvillimit të kodit;
- të shtojë klasat e *bootstrap* për strukturimin e *layout-it* në rreshta dhe kolona;
- të shtojë funksionalitete të gatshme sipas dokumentimit të *bootstrap*;

- të shtojë stilime të gatshme sipas dokumentimit të *bootstrap*;
- të shtojë efekte të gatshme nga libreria *Jquery* sipas dokumentimit të *bootstrap*;
- të testojë vazhdimisht kodin e shkruar;
- të shënojë komentet përkatëse përgjatë kodit të shkruar;
- të ngrejë nivelin profesional;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në kabinetin e kompjuterave.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet për ndërtimin programeve në gjuhën e programimit *Javascript* dhe të japë shembuj.
- Kursanti duhet të përdorin një editor ose *IDE* për shkrimin e kodit.
- Instruktori mund të përdori programe dhe shembuj të ndryshëm në internet të përdorimit të *Javascript* në faqe *web*.
- Kursantët duhet të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Kabinet me kompjutera me lidhje interneti.
 - Kompjuterat të kenë të instaluar sistemin e shfrytëzimit *windows*.
 - Materiale elektronike në mbështetje të trajtimit të modulit.
 - Materiale me lloje të ndryshme ushtrimesh në *Javascript*.
 - Programet e nevojshme të shkrimit të kodit.
 - Platforma në internet për shembuj modelesh të përdorimit të *Javascript* në faqe *web* të ndryshme.
-

4. Moduli “Testimi, publikimi dhe mirëmbajtja e faqeve web”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TESTIMI, PUBLIKIMI DHE MIRËMBAJTJA E FAQEVE WEB	MK-26-315-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të kryer testimin, publikimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të web-it.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të përdorin programet bazë kompjuterike dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti realizon testimin e faqes web para publikimit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë një listë kontrolli për testimin e faqeve web;– të realizojë kërkime mbi gjetjen e platformave në internet që kryejnë testimin e faqeve web;– të kryejë testimin e faqes nëpërmjet shërbimit online të ofruar nga W3C;– të testojë nëse gjuhët e programimit të përdorura janë konform standarteve;– të testojë nëse faqet janë konform dizenjës dhe layout-it të preferuar të faqeve web;– të ekzaminojë pamjen e faqes në shfletues dhe sisteme operative të ndryshme;– të testojë responsivitetin e faqes web në pajisjet mobile;– të identifikojë problemet dhe gabimet në kod;– të kontrollojë nëse adresat e link-ëve të drejtojnë në destinacionin e duhur;– të kontrollojë për mbingarkesë e faqet web;– të kontrollojë nëse faqet web janë user-friendly;– të testojë sigurinë e faqeve web;– të testojë performancën e faqeve web;– të rregullojë gabimet dhe problemet e identifikuar;– të dokumentojë problemet dhe zgjidhjet e bëra; Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje-përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti realizon publikimin online të faqes web. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë parametrat harduere të nevojshme për hostim;	

- të zbatojë teknikat e instalimit dhe konfigurimit të platformave dhe programeve të përdorura për web server;
- të përzgjedhë sistemin e hostimit web;
- të përzgjedhë domain-in dhe llojet DNS;
- të konfigurojë e-mail server-in;
- të zbatojë teknikat për regjistrimin e domain dhe menaxhimin e rekordeve *DNS* nëpërmjet platformave;
- të konfigurojë hostin nëpërmjet ndërfaqeve të menaxhimit si: cpanel, plesk etj.
- të zbatojë teknikat analizimit dhe optimizimit të hostit;
- të shkarkojë FileZilla nga faqja zyrtare në internet;
- të kryejë publikimin e një faqe web-i duke përdorur një program *FTP* si *FileZilla*;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti realizon mirëmbajtjen e faqeve web.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përcaktojë proceset e mirëmbajtjes së faqeve web;
- të sigurojë mbrojtje për faqen web nga sulmet, viruset, malware etj;
- të krijojë kopje të rregullta rezervë të faqeve (website back-up);
- të përditësojë (upgrade) gjuhët e programimit, sistemit dhe *CMS*-së dhe platformat, sa herë dalin versionet e reja;
- të përditësojë (*upgrade*) *plugin*-et;
- të përditësojë përmbajtjen e faqeve web;
- të optimizojë përmbajtjen në tekst, imazhe dhe video për faqet web;
- të përmirësojë pozicionimin e faqes web në motorët e kërkimit;
- të dokumentojë mirëmbajtjet mujore të faqeve të web;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe të plotësojë dokumentacionin teknik-financiar për shërbimin e kryer;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në laboratorin e praktikës me kompjutera.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë për zhvillimin e modulit faqe web-i të cilat përmbajnë gabime dhe probleme të simuluar me kodin dhe lidhjet e ndryshme të faqes
- Kursantët duhet të përdorin platforma pa pagesë që ofrohen në internet për testime dhe publikime faqesh web-i.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprime konkrete për testimin e faqeve web, identifikimin e problemeve dhe rregullimin e tyre.

-
- Instruktori i praktikës duhet të nxitë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Laborator me kompjutera në një rrjet lokal me lidhje interneti.
 - Modele të ndryshme faqesh web-i që do të përdoren për testim dhe publikim.
 - Shërbime të ndryshme hostimi;
 - Programe të ndryshme FTP.
-

5. Moduli “Dizenjimi i faqeve web nëpërmjet CMS-ve”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DIZENJIMI I FAQEVE WEB NËPËRMJET CMS-ve	MK-26-316-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të ndërtuar faqe web-i duke përdorur CMS të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të përdorin programet bazë kompjuterike dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti analizon dhe përzgjedh një nga CMS-të për ndërtimin e web-it Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të hulumtojë në internet për llojet dhe versionet e fundit të CMS-ve aktuale; – të përshkruajë funksionin, veçoritë dhe karakteristikat e CMS-ve; – të tregojë rëndësinë e përdorimit të CMS-ve në dizenjimin e faqeve web; – të përzgjedhë llojin e CMS-së në varësi të llojit të web-it që do të ndërtojë; – të përshkruajë kërkësat për hostim dhe standartin e sigurisë që përmban ky CMS; – të identifikojë profilet e përdoruesve të CMS-së; – të përgatisë plan propozimin e projektit për zhvillimin e faqes web me CMS; – të analizojë elementët përbërës të CMS-ve; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Kursanti instalon dhe përdor CMS për ndërtimin e web-it. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> – të instalojë CMS e përzgjedhur për ndërtimin e web-it; – të argumentojë përgjedhjen e CMS, dhe tematikën e ndërtimit të web-it. – të ndërtojë një faqe web me ndërfaqe të thjeshtë për përdoruesit; – të lidhëfaqen e web-it me një bazë të dhënash duke përdorur standartin e CMS; – të përcaktojë rolet e administrimit tëfaqes web në CMS; 	

- të prezantojë faqen e ndërtuar për një profil përdoruesi mobile;
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe të plotësojë dokumentacionin teknik financiar për shërbimin e kryer;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në laboratorin e praktikës së kompjuterave.
- Instruktori duhet të drejtojë kursantin në zgjedhjen e një CMS-je, në bazë të spotit që mund ti jepet kursantit me teknologjinë dhe sistemet e instaluar në laborator. Një shembull mund të jetë Wordpress.
- Kursantit duhet të bëjë kërkim në internet për materiale, tutoriale dhe shembuj për CMS-në të zgjedhur, dhe ti organizojë ato thjeshtë për demonstrim.
- Kursantit duhet të plotësojë një listë me web-e ekzistuese ku për ndërtimin e tyre është përdorur kjo lloj CMS-je.
- Instruktori duhet ti kërkojë kursantit që të instalojë modulet shtesë mbi web server që të bëjë të mundur shfrytëzimin e CMS-së.
- Instruktori duhet ti kërkojë kursantit në varësi të kompleksitetit të CMS, ndërtimin e një shembulli të thjeshtë funksional bazuar mbi përdorimin e kësaj CMS-je.
- Instruktori duhet të nxitë kursantit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të kursanteve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e duhur të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:

- Laborator me kompjuter në rrjet me lidhje interneti.
 - Kompjuterët duhet të kenë të instaluar sistemin e shfrytëzimit Windows, po kështu të instaluar arkitektura të kombinuara web server dhe interpretues të gjuhës skript në server, dhe në varësi të kërkesës së CMS-së, bazë të dhënash server, si dhe fleksibilitet për të bërë instalim të CMS.
 - Materiale elektronike dhe materiale të printuara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-